

Die Anhörung im Asylverfahren – albanische Übersetzung

Intervista në periudhën e kërkesës së azilit

Shënime për azilkërkuesit në Gjermani

4. izdanje, decembar 2016

Unabhängige Asylverfahrensberatung finden Sie an diesen Orten in Bielefeld:

- Unterkunft „Oldentruper Hof“, Niedernholz 2, Bielefeld
- Unterkunft „Hotel Südring“, Gütersloher Str. 259, Bielefeld
- Zentrale Ausländerbehörde (ZAB), Am Stadtholz 26, Bielefeld

You find independent consultation on the asylum process in the EAE Bielefeld here:

- Camp “Oldentruper Hof“, Niedernholz 2, Bielefeld
- Camp “Hotel Südring“, Gütersloher Str. 259, Bielefeld
- Zentrale Ausländerbehörde (ZAB), Am Stadtholz 26

Sie können mit diesen Personen sprechen: / You can talk with:



Richard Reifengerst, 0163/7400353 (Südring/ZAB)

Olga Lakizyuk, 0178/9090486 (Hotel Südring/ZAB)



Paulina Müller, 0521/546515-77 (Hotel Südring)

Ari Faizy, 0521/546515-64 (Hotel Südring)

Katharina Bracke, 0521/546515-62 (Oldentruper Hof/ZAB)

Durcan Kaya, 0521/546515-22 (Oldentruper Hof)



Pia Villasenor, 0521 / 23828916 (Oldentruper Hof/ZAB)



Fachdienste Migration
und Integration

Jan Plöger, 0521 / 30438896 (Oldentruper Hof/ZAB)




Die Anhörung im Asylverfahren – albanische Übersetzung

Intervista në periudhën e kërkesës së azilit

Shënime për azilkërkuesit në Gjermani

Botimi i katërt, Dhjetor 2016

Kjo broshurë ju është dorëzuar nga:



Këtë broshurë e gjeni edhe në www.asyl.net (nënfaqja „Arbeitshilfen/Publikationen“).

Impressum:

Die Anhörung im Asylverfahren, Hinweise für Asylsuchende in Deutschland.
4. Auflage, Dezember 2016

Herausgeber und ©: Informationsverbund Asyl und Migration e. V., Haus der Demokratie und Menschenrechte, Greifswalder Str. 4, 10405 Berlin, kontakt@asyl.net

Die erste Auflage wurde erstellt in Zusammenarbeit mit dem Info-Bus für Flüchtlinge, München.
V. i. S. d. P.: Michael Kalkmann, c/o Informationsverbund Asyl und Migration
Unveränderte und vollständige Vervielfältigung und Weitergabe ist gestattet.

Die Übersetzung ins Albanische wurde erarbeitet von OASA e. V. – Organisation Albanischer Studenten und Alumni in Berlin.

Die Inhalte des Merkblatts sowie die Übersetzungen wurden mit größtmöglicher Sorgfalt erstellt. Eine Haftung für inhaltliche Richtigkeit, Vollständigkeit und Aktualität der Informationen bzw. der Übersetzungen sowie für Schäden, die aus der Verwendung der Informationen bzw. der Übersetzungen entstehen, kann nicht übernommen werden. Rückmeldungen zur Qualität oder Aktualität der Informationen bzw. Übersetzungen richten Sie bitte an den Informationsverbund Asyl und Migration.

Die Erstellung und die Übersetzungen der 4. Auflage 2016 erfolgten im Rahmen des Programms „Koordination, Qualifizierung und Förderung der ehrenamtlichen Unterstützung von Flüchtlingen“. Das Programm und diese Publikation wurden gefördert durch die Beauftragte der Bundesregierung für Migration, Flüchtlinge und Integration.

Weitere Informationen zum Programm unter:

fluechtlingshelfer.info

Informationen für Flüchtlingshelferinnen und -helfer

Gefördert durch:



Die Beauftragte der Bundesregierung
für Migration, Flüchtlinge und
Integration

Wir sind's! 
Die Einwanderungsgesellschaft gestalten

Parathënie e kësaj broshurës


Me këtë broshurë duam të ju ofrojmë disa këshilla që ju shërbejnë për intervistën e kërkesës për azil. Intervista është pjesa më e rëndësishme, për të treguar shkaqet e ikjes. Kjo mund të sjellë vendimin se a do të mbroheni nga shteti gjerman. Për këtë arsye duhet të përgatiteni sa më mirë për intervistën.

Para intervistës konsultoheni me një **avokat** (Rechtsanwalt) apo **avokate** (Rechtsanwältin) ose me një **qendër këshilluese për refugjatë**. Në Gjermani ka një numër të madh të shoqatave të pavarura, të cilat refugjatët i këshillojnë pa pagesë dhe në mënyrë të pavarur. Informacionet mbi këto shoqata ju ofrohen në momentin që e dorëzoni kërkesën për azil. Nëse nuk ju ofrohen, pyesni nëpunësit e shërbimeve sociale në strehimin fillestar. Adresat e qendrave të konsultimit mund t' i gjeni edhe në internet në faqen www.asyl.net në seksionin „Adressen“.



Çfarë është kërkesa e azilit?


Një kërkesë për azil mund ta dorëzoni në zyrat e **Bundesamt für Migration und Flüchtlinge** (shkurt BAMF shq. Enti federal për migracion dhe refugjatë). Nëse kërkonte azil në zyrat e tjera shtetërore (si përshebull në polici), prej aty do të dërgoheni në BAMF. Më pas do të vendoset se cila zyrë e BAMF-it do të jetë përgjegjëse për kërkesën tuaj. Mund të jetë edhe në vendin ku ju ndodhni tashmë. Nëse ndodhet diku tjetër në Gjermani, duhet të udhëtoni atje. Është e rëndësishme që të shkoni në zyrën përkatëse pa hezitim. Përndryshe, procesi juaj i azilit mund të ketë pasoja dhe të dëmtohet rëndë.



Fatkeqësisht mund të ndodhë që kërkesa juaj për azil mos të pranohet menjëherë në zyrën përkatëse të BAMF-it. Në këtë rast, së paku duhet të ju dorëzohet një dokument i gjelbër identifikimi i titulluar „Ankunftsnachweis“ (shq. vërtetim mbërritjeje). Nëse kërkesa juaj për azil nuk pranohet as pas disa javësh, kontaktoni patjetër një shoqatë këshilluese në procesin e kërkesës së azilit.

Kur të dorëzoni kërkesën e azilit, do të fotografoheni dhe do të ju regjistrohen shenjat e gishtave. Këtu mund t'iu parashtrihen pyetje rreth personit tuaj, vendbanimit të fundit në shtetin nga e keni prejardhjen, për prindërit dhe gjyshërit e juaj si dhe udhëtimin për në Gjermani. Këto pyetje mund t'iu parashtrihen edhe më vonë gjatë intervistës, sepse procedura nuk është e njëjtë dhe domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

Pasi kërkesa juaj për azil të jetë regjistruar, do t'iu dorëzohet një vërtetim me titullin „Aufenthalts-gestattung“ (shq. leje qëndrimi). Shërben si dokument identifikimi dhe duhet ta mbani patjetër me vete.



E rëndësishme: Posta nga BAMF-i

- Nëse letrat nga BAMF-i nuk arrijnë te ju, mund të shkaktojë probleme për procesin tuaj të azilit. Prandaj, ju duhet të kontrolloni çdo ditë nëse ka postë për ju. Nëse në vendbanimin tuaj ka një postim ku arrijnë letrat të reja, kontrollojeni atë çdo ditë. Përndryshe, duhet të pyesni personin që shpërndanë postën në vendbanimin tuaj.
- Nëse ndërroni banesë ose dërgoheni në një vendbanim tjetër, menjëherë informoni BAMF-in mbi adresën tuaj të re. Jeni të detyruar të kryeni këtë komunikim edhe nëse zyrat e tjera njohin adresën tuaj të re. Nëse keni një avokat apo avokate, informoni edhe atë gjithashtu.

Për çfarë bëhet fjalë në periudhën e kërkesës së azilit?

Në periudhën e kërkesës së azilit BAMF-i verifikon këto pyetje:

- A është Gjermania përgjegjëse për kërkesën tuaj për azil? (Informacione mbi këtë gjëni në kutin e mëposhtme në këtë faqe)
- Nëse Gjermania e përpunon kërkesën tuaj për azil: A ishit në vendin e prejardhjes të përndjekur dhe çfarë mund t'iu ndodhë nëse ktheheni përsëri atje?

Mund të ju ngatërrojë fakti, që këto pyetje parashtrihen shpesh vetëm në një bisedë të vetme dhe herë të tjera në takime të ndryshme. BAMF-i ka për detyrë të ju informojë se për çfarë bëhet fjalë në fillim të bisedës.

Vendosja e përgjegjesisë në „Procesin e Dublinit“

Shumë shtete në Evropë, ndër ato edhe Gjermania, kanë nënshkruar marrëveshje njëra me tjetrën, që vetëm një shtet prej tyre të marrë përgjegjsinë për përpunimin e kërkesës për azil. Për këtë çështje këto shtete kanë nënshkruar një marrëveshje në Dublin, në kryeqytetin e Irlandës. Prosesi, nëpërmjet të cilit merret vendimi se cili shtet është përgjegjës për kërkesën e azilit, për këtë shkak quhet „Procesi i Dublinit“.

Në „Procesin e Dublinit“ mund të rezultojë, që kërkesa juaj për azil të mos përpunohet në Gjermani, por në një shtet tjetër evropian. Kjo është e mundëshme sidomos,

- nëse keni dorzuar një kërkesë për azil në një shtet tjetër evropian,
- nëse jeni regjistruar nga institucionet shtetërore në një shtet tjetër evropian,
- nëse keni udhëtuar me një vizë të një shteti tjetër evropian ose
- nëse keni ndonjë lloj vërtetimi që keni qëndruar në një shtet tjetër evropian.

Ju duhet patjetër të konsultoheni me një qendër këshilluese, me avokaten apo avokatin tuaj, nëse është e mundur, që mos të jetë Gjermania përgjegjëse për kërkesën tuaj për azil. Në këtë rast, mund të mbyllet procesi i azilit në Gjermani, pa marrë parasysh shkaqet e kërkesës tuaj. Kjo nuk do të thotë, që nuk është e mundëshme të pranohet azili në Evropë. Prandaj ju do të detyroheni, që kërkesën tuaj për azil të dorzoni për përpunim në shtetin përgjegjës. Gjithashtu edhe atje mund t'iu ofrohet mbrojtje.

BAMF-i është i detyruar, t'iu informojë mbi „Procesin e Dublinit“. Për këtë do t'iu dorëzohen shënime. Gjithashtu duhet të vijojë një bisedë, se çfarë është „Procesi i Dublinit“. Kjo bisedë mund të lidhet së bashku me intervistën, te cila i tregoni shkaqet për kërkesën e azilit. Por mund të vijoj edhe ndarë prej intervistës. Nëse ka shkaqe të rëndësishme, përse kërkesa juaj për azil duhet të përpunohet patjetër në Gjermani dhe jo në një shtet tjetër të Evropës, duhet të tregoni shkaqet në këtë bisedë. Për shembull, nëse keni anëtarë të familjes në Gjermani ose nëse i brengoseni shkeljeve të të drejtave të njeriut në një shtet tjetër evropian, atëherë përmendeni këtë patjetër në bisedën tuaj.

Nëse në një shtet tjetër evropian është marrë një vendim mbi kërkesën tuaj për azil, normalisht nuk do të procesohet edhe një kërkesë tjetër në Gjermani. Ka edhe përjashtime. Për këtë konsultohuni patjetër me një qendër këshilluese ose me avokaten/avokatin tuaj.

Çfarë verifikohet në procesin e azilit?

Nëse kërkesa juaj për azil do të përpunohet në Gjermani, në qëndër të vëmendjes është pyetja nëse ju do të njiheni si **refugjat** („**Flüchtling**“). Faktor vendimtar në këtë proces është nëse egziston rreziku që ju të përndiqeni në vendin tuaj pas kthimit. Nën përndjekje nënkuptohet nëse rrezikohen të drejtat e njeriut, me pasoja të rënda për ju. Kjo vlen para së gjithash nëse jeta juaj është në rrezik, ose nëse ju kërcënohen dëmtime trupore ose cenim të lirisë. Gjithashtu merren parasysh nëse ju janë shkelur të drejtat e njeriut për shkak të një „tipari/veçorie“. Këto mund të jenë tiparet e një njeriu (ngjyra e lekurës, gjinia, orientimi seksual), po ashtu edhe qëndrimi politik dhe fetar.

Nëse nuk vërehet një rrezik, nuk do të thotë që verifikimi i kërkesës së azilit mbaron. BAMF-i duhet të verifikojë gjithashtu, nëse ka rreziqe tjera në shtetin tuaj. Për shembull mund të ju garantohet „mbrojtje shtesë“ („**subsidiärer Schutz**“), nëse për ju rezultojnë rreziqe nga një luftë qytetare në shtetin tuaj.

Gjithashtu kontrollohet nëse juve iu kanosen rreziqe tjera të rënda. Ky mund ty jetë rasti, nëse për shkak të një sëmundjeje ose prej rrethanave tuaja të veçanta ju nuk mund të mbijetoni në vendlindjen tuaj. Nëse ky është rasti juaj, atëherë BAMF-i duhet të deklarojë një „**Abschiebungsverbot**“ (ndalim dëbimi).

E rëndësishme është pyetja, para se të largoheni për në Gjermani, nëse ka pasur ndonjë vend tjetër ku mund të kishit gjetur sigurinë e duhur. Kjo mund të jetë në një shtet tjetër ose në një rajon tjetër të shtetit tuaj. Nëse institucionet gjermane vërejnë që është e mundur që në një vend tjetër mund të ktheheni dhe mbroheni, në këtë rast mbrojtja në Gjermani nuk merret përsipër.

Ftesa për intervistë

Intervista është vendimtare, nëse do të ketë sukses kërkesa juaj për azil. Kjo vlen edhe atëherë, nëse ju keni treguar shkaqet e ikjes pranë institucioneve tjera (për shembull në polici) ose gjatë regjistrimit në strehimin pranues. Me rëndësi është, se çfarë thoni në intervistën e BAMF-it.

Mund të ndodhë që intervista të zhvillohet direkt disa orë ose disa ditë pas dorëzimit të kërkesës për azil. Por, deri sa të ju caktohet një takim për intervistë mund të kalojnë edhe muaj. Në disa zyra të BAMF-it, personave nga vende të caktuara u përcaktohet takimi më shpejtë, në rast se sipas BAMF-it konsiderohet se kërkesat e tyre mund të kenë shanse shumë të mira ose shumë të këqija për tu pranuar. Në këtë mënyrë, BAMF-i shpreson të marrë një vendim të shpejtë mbi personat nga këto vende. Fakti që intervista juaj bëhet shpejt pas dorëzimit të kërkesës, ky nuk është domosdoshmërisht një sinjal i mirë apo i keq mbi shanset e pranimit të kërkesës tuaj. Procesi mund të zgjasë edhe shumë, ngaqë zyra e BAMF-it duhet të përpunojë edhe shumë kërkesa tjera para kërkesës tuaj. Në çdo rast, BAMF-i duhet të verifikojë arsyet që keni përmendur gjatë intervistës dhe nuk mund të refuzojë kërkesën tuaj vetëm sepse vini nga një shtet i caktuar.

Është e mundur që BAMF-i të ju caktojë edhe një takim tjetër gjatë të cilit ju parashtrihen pyetje se a keni qëndruar në një shtet tjetër evropian. Qëllimi i këtyre pyetjeve është që të konstatohet nëse një shtet tjetër evropian është përgjegjës për përpunimin e kërkesës tuaj për azil. Ky takim do të thotë i përket “Procesit të Dublinit” (Informacione për këtë gjëni në kutinë në faqen 3).

Nëse kërkesa juaj për azil nuk refuzohet para kohe sipas „Procesit të Dublinit“, do të ftohemi me shkrim për „Anhörung gemäß § 25 Asylgesetz“ (shq. Intervistë sipas § 25 ligjit për procedurën e kërkesës për azil). Nëse - për shkak të një sëmundje - nuk mundeni të shkoni në takim e caktuar, duhet të njoftoni BAMF-in së shpejti dhe të merrni një vërtetim nga mjeku. Mund të ndodhë që ftesa për intervistë mbërrinë te ju me vonesë dhe ju nuk mund të shkoni në kohë në takim ose e humbni atë. Në një rast të këtillë, duhet të informoni menjëherë BAMF-in dhe të flisni me një qendër këshillimi ose me një avokat ose avokate. Nëse nuk ishte faji juaj që munguat në takim, atëherë BAMF-i duhet të ju caktojë një takim të ri.

Në intervistë do të pyeteni personalisht nga një nëpunës i BAMF-it për shkaqet e ikjes. Intervista është mundësia më e rëndësishme që mund të shfrytëzoni, për të dhënë shkaqe të vlefshme për kërkesën e azilit. Duhet ta keni parasysh të mos harroni takimin e caktuar dhe të përgatiteni sa më mirë. Mos vonoheni për takimin e caktuar dhe mundoheni të jeni në kohë e caktuar prezent. Në raste të veçanta mund të zgjasë edhe më gjatë, deri sa të fillojë intervista. Përgatituni edhe merreni diçka për të ngrënë dhe ndonjë pije.


Shënime për intervistën

Mundohuni që para intervistës të mbani mend detaje më të rëndësishme të shkaqeve prej të cilave jeni larguar nga shteti juaj. Është mirë që datat më të rëndësishme dhe shkaqet e ikjes t'iu shkruani edhe në një letër. Kjo ju mundëson që të orientoheni dhe të njihni paqartësitë që mund t'iu ndodhin gjatë intervistës. Mos ia dorëzoni këto shënime BAMF-it dhe mos i merreni me vete gjatë intervistës. Kështu askush nuk do të mendojë se keni një tregim të parapërgatitur. Duhet të keni parasysh se gjatë intervistës do t'ju duhet të tregoni edhe ngjarje që për ju janë të vështira apo edhe rënda.

Nëse ju si grua nuk mundet të flisni për dhunime ose situata të rënda që keni përjetuar, ngaqë nëpunësi i BAMF-it është burrë, ju lutemi që të tregoni sa më para. Në BAMF ka nëpunëse femra të cilat janë të specializuara pikërisht për intervistën vetëm për femra. Gjithashtu, në BAMF ka edhe



nëpunës të specializuar për komunikimin dhe intervistat me fëmijë, adoleshentë, persona që kanë sëmundje mendore dhe persona të traumatizuar. Edhe nëse jeni të përndjekur për shkak të orientimit seksual, mund të dëgjoheni në intervistë nga nëpunës të cilët janë të specializuar pikërisht për këtë. Informoni BAMF-in paraprakisht nëse ju duhet të flisni me një nëpunës të specializuar në këto raste.



Gjatë intervistës është një **përkthyes apo përkthyes** i/e pranishëm/e. Njoftoni ju lutemi sa më parë BAMF-in në cilën gjuhë doni ta bëni intervistën. Duhet të jetë një gjuhë në të cilën mund të shpjegoni rethanat tuaja sa më mirë. Edhe nëse dëshironi një përkthyes, mund ti tregoni BAMF-it.

Pranë përkthyesit ose përkthyeses nga BAMF-i, ju keni të drejtën të merrni një person të besueshëm me vete gjatë intervistës. Ky person duhet të zotërojë mirë gjuhën tuaj si dhe gjuhën gjermane. Këtij personi nuk i lejohet përkthimi i plotë i pyetjeve dhe përgjigjeve, por ai mund të kontrollojë nëse është përkthyer korrektësisht dhe më tej mund të ndihmojë komunikimin. Një person kështu të zgjedhur merrni me vete vetëm nëse



mund të flisni lirshëm mbi gjithçka para tij/saj. Ky person mund të ndihmojë vetëm me përkthimin për ju dhe nuk i lejohet në asnjë mënyrë, në vendin tuaj, të prezantojë arsyet e largimit tuaj vetvetiu.

Përkthyesi ose përkthyesja duhet të përkthejë në detajë atë që thoni. Ai ose ajo ka për detyrë vetëm të përkthejë atë që thoni ju dhe pyetjet e nëpunësit të BAMF-it, dhe jo të japë informacione dhe shpjegime tjera. Nëse mendoni se përkthyesi ose përkthyesja nuk e bën këtë detyrë siç duhet ju lutemi jepni një shenjë nëpunësve të BAMF-it. Nëse mendoni se ka keqkuptime të mëdha, kërkoni që intervista të bëhen me një përkthyes apo përkthyes tjetër. Sigurisht, duhet të kërkoni që kritika dhe dyshimet e juaja të protokollohen.

Nëse keni ndonjë **dëshmi me shkrim** nga kush jeni të përndjekur, tregoni këto dokumente më së voni para intervistës. Këto dokumente mund të jenë (p. sh. dokumente institucionale, fletëvërtetim nga partia politike, organizatë religjioze etj.) artikuj të ndonjë gazete për ndonjë ngjarje, e cila ju ka përfshirë edhe juve. BAMF-i i shton këto dokumente në dosjen tuaj. Kërkoni që BAMF-i t'iu bëjë një kopje të dokumentave. Nëse mendoni se shoqëria ose familja mund t'iu dërgojnë ndonjë dokument nga vendi nga keni ikur, njoftoni për këtë BAMF-in. Dokumentet mund të jenë shumë të vlefshme si dëshmi. E rëndësishme është prapsepapë se çfarë thoni në intervistë. Mos dërgoni dokumenta të falsifikuar. Këto dallohen gati çdoherë dhe rezultojnë në pavlefshmërinë e gjithë deklarimeve tuaja.

Nëse keni dokumente që dëshmojnë fluturimin për në Gjermani (p.sh. biletën e fluturimit ose boarding card) dorëzoni këto në BAMF.



Nëse keni një **avokate** apo një **avokat**, ai ose ajo mund të marrë gjithashtu pjesë në intervistë. Ju keni gjithashtu të drejtën të keni një **person të besueshëm** si „Beistand“ (shq. mbështetës) gjatë intervistës. Në rastin më të mirë, gjeni një këshilltar ose këshilltare që njeh të drejtën e azilit dhe ka përgatitur intervistën së bashku me ju. Si rregull, nuk është e mundur që të ju shoqërojë një familjar i juaj si person i besueshëm i cili gjithashtu ka dorëzuar një kërkesë për azil. Nëse doni të shoqëroheshi nga një person i besueshëm, njoftoni BAMF-in sa më parë. Ju lutem sjellni këtë person, vetëm

nëse ai/ajo mund të shprehet lirshëm para jush mbi gjithçka. Ky person nuk mund të argumentojë mbi kërkesën tuaj, por thjesht të sigurohet që nuk harroni të përmendni diçka të rëndësishme.

Vijimi i intervistës

Intervista fillon shpesh me një rradhë pyetjesh. Bëhet fjalë për lidhjet tuaja personale – përshembull mund të ju pyesin për bashkëshortin ose bashkëshorten tuaj, fëmijët, prindërit dhe profesionin – por edhe mbi udhëtimin tuaj. Nëse këto pyetje janë parashtruar më parë, atëherë nëpunësit e BAMF-it do të pyesin vetëm shkurtimisht për ktë. Gjatë këtyre pyetjeve, pritet që ju të përgjigjeni shkurt dhe në mënyrë direkte.

Por, kur të ju pyesin mbi arsyet e largimit, duhet të përgjigjeni gjërë e gjatë. Në këtë moment pritet që ju të përshkruani arsyet e largimit tuaj, edhe nëse nuk ju shtrohen pyetje të tjera mbi të. Merrni gjithë kohën që ju duhet për tu përgjigjur. Nëpërmjet një përshkrimi të detajuar dhe të saktë, përmirësohen shanset që nëpunësit e BAMF-it t'iu besojnë. Përshkruani në detaje se çfarë ju frikëson për tu kthyer në vendlindjen tuaj. Mos përshkruani situatën e përgjithshme politike në vend, përveç nëse pyeteni specifikisht për të.

Ju lutemi mos i përshkruani ngjarjet tërthorazi (si për shembull, „familja ime ka pasur problem me policinë“) por përgjigjuni saktë mbi çfarë ka ndodhur. Si ndihmë mund të përdorni këto pyetje:

- „Çfarë ka ndodhur dhe si ka ndodhur?“
- „Kur dhe ku ka ndodhur?“
- „Kush ishte i pranishëm?“
- „Pse ka ndodhur?“

Edhe nëse kërkohet një përshkrim i saktë, nuk do të thotë, që duhet t'iu rikujtohen gjitha detajet ose secilës pyetje t'ia gjeni një përgjigje. Për shembull, është normale, që nuk ju kujtohet data e një ngjarjeje të kaluar para një kohe të gjatë. Në këtë rast nuk duhet të qëlloni datën e saktë ose ta shpikni nga mendja një datë. Kjo mund të bjerë në kundërshtim me ndonjë nga thëniet e juaja. Thoni më mirë, që nuk ju kujtohet data e saktë dhe mundoheni, që ta përkufizoni me ndihmën e datave të tjera (si p.sh.: „diku afër dy javë para ditëlindjes të babait tim“ ose „duhet të kishte qenë dimër, se isha veshur trashë“).

Në rethin e azilkërkuesve shpeshherë fliten „llafe“ dhe „histori“ me të cilat thuhet se pranohet kërkesa e azilit në BAMF. Mos ju besoni këtyre dhe mos lejoni që të kenë ndikim në ju. Nëpunësit e BAMF-it e dinë situatën në vendlindjen tuaj dhe i dallojnë informacionet e rrejshme. Në këtë rast, ka mundësi që pastaj të mos besojnë as informacionet tjera të vërteta që i keni dhënë.

Ndoshta ka ngjarje, mbi të cilat ju nuk mund të flisni përballë një të panjohuri/e. Mos i lini këto ngjarje pa i përmendur por flisni për ato, kur dhe ku kanë ndodhur si dhe arsyet përse nuk mund t'iu përshkruani në detaje.


Ka mundësi që nëpunësit e BAMF-it të parashtrorjnë pyetje për disa pika të caktuara përsëri. Prandaj ju nuk duhet të përgjigjeni sa më shkurtë këtyre pyetjeve, por duhet të prezantoni të gjitha pikat e rëndësishme sa më gjërë, edhe nëse nuk jeni pyetur sakt për atë. Përgjigjuni çdoherë pasi të keni kuptuar plotësisht pyetjen. Nëse nuk e kuptoni pyetjen plotësisht, pyesni edhe njëherë çfarë ishte pyetja e saktë.

Nëse vuani nga ndonjë sëmundje, duhet ti tregoni BAMF-it. Kjo është sidomos e rëndësishme nëse vini nga një shtet që nuk ka sistem funksional shëndetsor ose nëse nuk mundet të paguani shpenzimet e shërimit.

Mos u ngutni. Merrni aq kohë sa ju duhet. Në raste të vështira mund ta ndërprisni intervistën dhe të bëni një pushim ose të vazhdoni në një ditë tjetër.

Protokolli

Përgjigjet dhe të dhënat e juaja do të protokollohen. Nëpunësit e BAMF-it e diktojnë të gjithë përmbajtjen e protokollit gjatë intervistës në një inçizim, i cili më vonë kalon në letër. Aty nuk do të shkruhet fjalë për fjalë se çfarë keni thënë gjatë intervistës. Andaj, nëpunësit e BAMF-it bëjnë vetëm një përmbledhje. Gjatë protokollimit mund të bëhen edhe gabime, prandaj është shumë e rëndësishme që ju të kontrolloni nëse është përmbledhur çdogjë dhe ajo është bërë korrektësisht. Protokolli duhet t'iu përkthehet juve fjalë për fjalë, nëse dëshironi këtë. Në fillim të intervistës ju mund të kërkonti përkthimin e protokollit. Nëpunësit e BAMF-it pyesin shpeshherë nëse ju dëshironi që ripërkthimi të zhduket/asgjësohet. Është mirë që ju ta kërkonti këtë. Nëse gjeni ndonjë gabim ose keqkuptim, kërkonti që ato të përmirësohen dhe të korrigjohen. Protokolli është dokumenti më i rëndësishëm në kërkesën për azil. Është e mundëshme që një person tjetër nga BAMF-i, i cili nuk ka marrë pjesë në intervistë dhe nuk ka biseduar asnjëherë me ju, të marrë vendimin për kërkesën tuaj për azil duke u bazuar vetëm në protokollin që ka përpara.



Në fund do të kërkohet nga ju që të nënshkruani protokollin. Duke bërë këtë, ju konfirmoni që keni arritur të prezantoni të gjithë informacionet e rëndësishme, që keni kuptuar gjithçka dhe që protokollin ju është përkthyer gjithashtu. Mos nënshkruani nëse ky nuk ishte rasti në fjalë ose nëse protokollin përmbanë gabime. Në këtë rast, flisni sa më shpejt pas intervistës me një qendër këshillimi, një avokate ose një avokat.

Kërkonti që një kopje e protokollit të ju dorëzohet ose të ju dërgohet para se të merret vendimi i BAMF-it. Si rregull, protokollin ju dërgohet pas disa javësh me postë. Kontrolloni me ndihmën e një personi tjetër, i cili mund t'ua përkthejë përmbajtjen e letrës. Vëreni se a është shënuar gjithçka korrektësisht dhe plotësisht. Nëse keni angazhuar një avokat apo avokate, protokollin fillimisht do t'iu dërgohet atyre dhe më pas juve ose të paktën do të bisedoni për këtë. Përndryshe kërkonti ndihmë nga një qendër këshilluese që të kërkojë nga BAMF-i përmirësimin e gabimeve.

Vendimi i BAMF-it

Vendimi i BAMF-it për kërkesën tuaj për azil („Bescheid“) do të vijë me postë. Për këtë arsye pas intervistës, duhet të kontrolloni çdo ditë, nëse ka postë për ju. Nëse në strehimin e përkohshëm, në të cilin ndodheni, ka një kuti për postën e posaçdhur, kontrolloni atë çdo ditë. Përndryshe pyesni personin që shpërndanë postën në strahimin ku qëndroni. Nëse ju keni një avokat apo avokate, atherë BAMF-i mund t'ua dërgojë vendimin në zyrën e avokatit. Sigurohuni që avokati apo avokatja juaj të ketë mundësi t'iu kontaktojë në çdo kohë.



Nëse ju vjen përgjigja negative, është e drejta juaj dhe keni mundësinë të kundërshtoni në gjykatë. Për këtë keni shumë pak kohë. Keni kujdes se çfarë shkruan në faqen e parë të vendimit:

- Nëse në faqen e parë shkruan, „Der Antrag auf Zuerkennung der Flüchtlingseigenschaft wird **abgelehnt**“, („Kërkesa për azil nuk pranohet“), si rregull keni dy javë kohë që të kundërshtoni në gjykatë. Kjo vlenë edhe për rastet kur juve iu është dhënë „mbrojtje shtesë“ (subsidiärer Schutz), por ju doni të arrini të njiheni si refugjat.
- Nëse në faqen e parë të vendimit shkruan „Der Antrag auf Zuerkennung der Flüchtlingseigenschaft wird als **offensichtlich unbegründet abgelehnt**“, („Kërkesa për azil nuk pranohet ngaqë është dukshëm e pabazë“). Në këtë rast keni vetëm një javë kohë që vendimin ta kundërshtoni në gjykatë.
- Nëse në faqen e parë të vendimit shkruan „Der Antrag auf Zuerkennung der Flüchtlingseigenschaft wird als **unzulässig abgelehnt**“, („Kërkesa juaj për azil refuzohet si e papranueshme“), BAMF-i ka marrë vendimin që nuk duhet të zhvillohet një proces azili, pasi përshembull, përgjegjësia i takon një shteti tjetër. Edhe në këtë rast keni vetëm një javë kohë që të kundërshtoni me shkrim në gjykatë.

Në çdo rast duhet të verifikoni nëse është racionale/ka kuptim që t'iu drejtoheni gjykatës. Sidoqoftë duhet patjetër të kontaktoni avokatin apo avokaten tuaj ose një qendër këshilluese në po të njejtën ditë.



Fragen zur Anhörung? Schaut diesen **FILM** auf Deutsch
 Questions about the hearing? Watch this **FILM** in English
 Pitanja za saslušanje? Pogledaj ovaj **FILM** na srpskom
 Pitanja za saslušanje? Pogledaj ovaj **FILM** na bosanskom
 Ke pyet je rreth intervistës? Atehere shiko këtu këtë **FILM** në shqip
 هل لديكم أسئلة بشأن جلسة الاستماع؟ شاهدوا هذا **الفيلم** باللغة العربية.
 Pirsên we li ser jêpirsinê Hene li vî **filimî** bi zaravê kurmancî binêrin
 پرسپار بو گوپگرتن؟ تماشای نم **فیلمه** بکن به زمانی سوزانی
 در باره ی مصاحبه پرسش دارید؟ نسخه ی فارسی این **فیلم** را تماشا کنید.



ASYL IN DEUTSCHLAND DIE ANHÖRUNG

www.asylindeutschland.de
facebook.com/asylindeutschland
[#asylingermany](https://twitter.com/asylingermany)

Si vous avez des questions sur l'audition, regardez ce **FILM** en français
 Suúalo ku saabsan Interfiyuuqad Daawo **Filmkaan** oo Luuqad Somaali ah
 താസി ട അന്തരവുപെ അറികെ പുസ്തന്തി **ഫിലം** റരി? ടا
 په پښتوربه وگوری.
 کیا انٹرویو کے بارے میں سوالات ہیں؟ اس **فلم** کو اردو زبان میں دیکھو۔
 Duruşma hakkında kafanız takılan sorular mı var? Öyleyse bu **filmi** izleyin
 Есть вопросы по слушанию? Посмотри это **ВИДЕО** на русском языке
 Прашања за сослушувањето? Погледни го овој **Филм** на македонски
 سوالاتی در در رابطه با مصاحبه داری؟ این **فیلم** را بزبان در ی نگاه کن.